



Këshilli Prokurorial Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

Nr. Ref: KPK/Nr. 413 /2021

Data: 24.06.2021

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK),

CIVIKOS-it dhe KMSHK-së

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), duke u mbështetur në Ligjin për KPK-në, nënshkruan këtë memorandum bashkëpunimi me organizatat përfaqësuese të shoqërisë civile dhe përfaqësuese të komunitetit të gazetarëve.

Qëllimi i këtij memorandumi është ndërtimi i standardeve të komunikimit në mes KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, në njërën anë, dhe shoqërisë civile dhe mediave, në anën tjetër, gjithmonë duke respektuar legjislacionin penal, Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, Ligjin për Sinjalizuesit dhe ligjet e tjera.

Ky memorandum veçanërisht synon ndërtimin e kapaciteteve dhe të rrugëve të komunikimit për raportimin e rasteve të veprave penale te Prokurori e Shtetit, të identifikuar nga shoqëria civile dhe mediat. Në këtë mënyrë, përmirësohet cilësia e raportimeve dhe informacioneve që dërgohen në Prokurorin e Shtetit, respektivisht përmes vënies në dispozicion të informatave dhe raportimeve cilësore e përmbajtësore ndihmohet e lehtësohet puna e Prokurorit të Shtetit.

Pavarësisht kësaj marrëveshjeje, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat rezervojnë të drejtën që të ndërmarrin forma tjera të veprimtarisë në lidhje me informimin për vepra të mundshme penale, varësisht se si ato e vlerësojnë të nevojshme dhe të përshtatshme për përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të tyre.

Për këtë qëllim, palët zotohen për çështjet si në vijim:

Neni 1

Organizatat nënshkruese të këtij memorandum, në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorin e Shtetit do të angazhohen të ndërtojnë procedurat standarde të raportimit të rasteve nga OJQ-të dhe mediat te Prokurori i Shtetit.

Neni 2

Me qëllim të realizimit të këtij memorandum palët pajtohen që bashkërisht dhe ndarazi:

- të hartojnë formularin bazik për raportimin e rasteve në prokurori;
- rastet e dorëzuara nëpërmjet formularit të emërtohen si raporte informuese dhe të futen në regjistrin zyrtar të prokurorisë;
- të ofrojnë trajnime dhe informacione për OJQ-të dhe mediat për mënyrën e adresimit të kërkesave të formularit;
- të informojnë zyrat e pranimit të lëndëve në Prokurorin e Shtetit për ekzistencën e formularit;
- të informojnë mediat dhe shoqërinë civile për formularin;
- të publikojnë në uebfaqe formularin bazik të raportimit të rasteve;

- të ofrojnë këshilla dhe trajnime për OJQ-të dhe mediat për fusha specifike;
- të angazhohen në krijimin e resurseve brenda sistemit online të raportimit të rasteve.

Neni 3

Me qëllim të implementimit të këtij memorandumi, palët pajtohen për kryerjen e aktiviteteve në kohën e përcaktuar.

Me mbështetjen e programit të USAID-it, pas përfundimit të një procesi konsultativ, një ekspert i pavarur do ta përgatitë dhe dërgojë për miratim në KPK formularin bazik të raportimit të rasteve. KPK brenda një muaji do ta miratojë këtë formular.

Pas diskutimit dhe miratimit të formularit, KPK-ja do ta vë formularin në faqen e vet zyrtare dhe në atë të Prokurorit të Shtetit.

Formulari do vendoset edhe në faqen e CIVIKOS-it, KMSHK-së dhe organizatave tjera partnere.

Brenda fushëveprimit të këtij memorandumi, KPK-ja do t'i angazhojë resurset e saj për t'iu përgjigjur kërkesave të OJQ-ve për trajnime në identifikimin dhe adresimin e rasteve në prokurori.

KPK-ja dhe Sekretariati i KPK-së, në bashkëpunim me OJQ-të, do të angazhohen që brenda vitit të kërkojnë mbështetjen e donatorëve për të nisur procesin e digjitalizimit të procesit të dorëzimit të rasteve nga OJQ-të dhe mediat në Prokurorinë e Shtetit.

Palët nënshkruese zotohen që në mirëbesim do t'i përmbushin obligimet nga ky memorandum dhe njëkohësisht angazhohen dhe vënë në dispozicion kapacitetet e tyre njerëzore dhe infrastrukturore me qëllim të realizimit të marrëveshjes.

Neni 4

Palët pajtohen që, me qëllim të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve nga kjo marrëveshje, të caktojnë nga një person kontaktues të cilët do ta lehtësojnë zbatimin e saj (marrëveshjes).

Neni 5

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje me njoftim paraprak prej 30 ditësh mund të heqin dorë nga obligimet që rrjedhin prej saj.

Neni 6

Ky memorandum është përpiluar në 3 kopje identike, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët nënshkruese.


Neni 7

Në rast të mosmarrëveshjeve të mundshme në lidhje me këtë memorandum mirëkuptimi, palët pajtohen që ato të zgjidhen përmes negociatave dhe marrëveshjeve.

Këshilli Prokurorial i Kosovës



CIVIKOS



KMSHK

